



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.Shk II.nr. 88/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbartimore të kreditorit “Ndërmarrja Publike Banesore” ShA me seli në rrugën Zija Shemsiu nr.22 në Prishtinë kundër debitorit “N.Sh. Biliardo-Genti” me seli në rr. Agim Ramadani nr. 22/55 në Prishtinë, i cili përfaqësohet sipas prokurës nga avokati A.B. me seli në bulevardin Dëshmorët e Kombit, D1, H5, nr. 5 në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2491/22 të datës 31.10.2023, me datë 24.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Ndërmarrja Publike Banesore SH.A., me seli në Prishtinë , ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2491/22 të datës 31.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2491/22 të datës 31.10.2023, në pikën e parë të dispozitivit ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “N.Sh. Biliardo-Genti” me seli në Prishtinë dhe ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.563/2021 i datës 16.07.2021 i përmbartuesit privat Irfan Kërçagu me seli në Prishtinë dhe është përfunduar në tërësi procedura përmbartimore në këtë çështje.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të

ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale , Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2491/22 të datës 31.10.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Ndërmarrja Publike Banesore SH.A., me seli në Prishtinë, me dt. 14.12.2018 ka paraqitur propozim për përmbaremore , me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori “N.Sh. Biliardo-Genti” me seli në Prishtinë (këtu e tutje Debitori) që t’ia paguaj shumën prej 31,840.11€ me kamatëvonesë vjetore prej 8% dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore. Propozimin për përmbaremore e kishte bazuar në kartelën financiare të datës 04.12.2018 të lëshuara nga Kreditori për Debitorin (këtu e tutje Ekstrakti) dhe faturën 2021/1922 të datës 01.06.2021 të lëshuar nga Kreditori për Debitorin (këtu e tutje Fatura), të cilat ia ka bashkëngjitur Propozimit.

Përmbareuesi më 16.07.2021 e ka nxjerrë urdhrin përmbaremore P.nr.563/2021, me të cilin e ka lejuar në tërësi përmbaremoren sipas Propozimit. Debitori më 03.08.2022 ka parashtruar prapësim duke e kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbaremore dhe i ka kërkuar gjykatës që ta anuloj atë. Ai ka pretenduar se fatura është e pa nënshkruara nga ai, rrjedhimisht mungojnë kushtet që të përmbaremoret pa u zgjedhur kontesti lidhur me borxhin mes Kreditorit dhe Debitorit. Më tutje ka deklaruar se fatura nuk mund të konsiderohet dokument i besueshëm, meqenëse ajo nuk është e nënshkruar nga ai. Prapësimit nuk ia ka bashkëngjitur asnjë provë, si dhe nuk e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale lidhur me paraqitjen e Prapësimit përmes avokatit.

Kreditori në përgjigjen e tij në Prapësim ka kërkuar që të refuzohet në tërësi si i pabazuar Prapësimi i Debitorit. Ai ka deklaruar se Fatura është kthyesë, si dhe e përmban nënshkrimin e personit të autorizuar të Kreditorit dhe të pranuesit (Debitorit). Ka shtuar se Debitori nuk ka paraqitur prova për t’i provuar pretendimet tij dhe se nuk është provuar se ekziston ndonjëra nga bazat e nenit 71 të LPP-së, ashtu siç e obligon nenit 69 para. 4 i LPP-së. Përgjigjes në prapësim nuk ia ka bashkëngjitur asnjë provë, si dhe nuk e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale lidhur me paraqitjen e përgjigjes në prapësim

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2491/22 të datës 31.10.2023, ku në dispozitiv të aktvendimit ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “N.Sh. Biliardo-Genti” me seli në Prishtinë, dhe ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.563/2021 i datës 16.07.2021 i përmbaruesit privat Irfan Kërçagu me seli në Prishtinë dhe është përfunduar në tërësi procedura përmbarimore në këtë çështje.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se ekstraktit (kartelës financiare) ashtu edhe faturës lëndore u mungojnë të dy format e përcaktimit të kohës për përmbushjen, gjegjësisht në ato nuk është caktuar koha e përmbushjes së detyrimit qoftë në formë të afatit ose qoftë në formë të datës fikse, e as nuk është përcaktuar në formë të deklaratës lidhur me arritshmërinë e kërkesës, rrjedhimisht nuk është plotësuar kërkesa ligjore për tregimin e kohës së përmbushjes së detyrimit në dokumentin e besueshëm.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur në pikën e parë të dispozitivit ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikim nga shkresat e lëndës dokumentet mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk i plotësojnë kushtet që të konsiderohen dokument i besueshëm, ashtu siç përcaktohet me nenin 29 të LPP-së, “1. Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, 3 sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çequet me potest dhe faturë kthyese, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës; 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave; 1.3. faturat; 1.4. dokumentet që sipas dispozitave ligjore të posaçme kanë rëndësinë e dokumenteve publike;”, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se fatura nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret nga kjo faturë nuk mund të vërtetohet se për cilën periudhë kohore është kërkuar borxhi, andaj shërbimi i përshkruar në këtë faturë nuk përputhet me borxhin total i cili kërkohet sipas të njëjtës, andaj më të drejtë ka vendosur Gjykata e Shkallës së Parë.

Ndërsa sa i përket kartelës financiare e dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilit përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin, nuk konsiderohet dokument i besueshëm ngase në kuadër të dokumenteve të besueshme janë ekstraktet e verifikuara nga librat afariste vetëm sa i përket pagesave të shërbimeve komunale për furnizim me ujë, energji elektrike dhe bartje të mbeturinave.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Andaj qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, ndërsa pretendimet ankimore të kreditorit lidhur me gjendjen faktike rezultojnë si të pathemelta të cilat kjo gjykatë i refuzoi si të pabazuara ndërsa aktvendimin e atakuar vendosi që ta vërtetojë.

Përndryshe në procedurën përmbarrimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarrimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarrues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarrimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.88/24 me datë 24.04.2024

Gjyqtarja,
Saranda Bogaj Sheremeti